



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

---  
**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**  
të dëgjimit publik për Kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2023-2025,  
mbajtur më 15.06.2022, me fillim në orën 10:00.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi Osman Bllaca, zyrtar i Komunës, duke i falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje.

Të pranishëm ishin: Fehmi Kupina, kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Arta Balaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donika Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit dhe Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Osman Bllaca theksoi se ky diskutim është thirrur për Kornizën afatmesme buxhetore, që është një dokumente strategjik i Komunës, e që ka për qëllim të tregojë për të hyrat e Komunës për tri vitet e ardhshme, që janë për vitet 2023 - 2024 - 2025.

**Valbona Ahmeti - Makolli** i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje në bashkëbisedim lidhur me versionin e Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025, ku sot jemi me ju dëgjuar juve dhe me i parë mundësitë buxhetore të cilat mundën me u inkorporuar. Jemi duke folur vetëm për projektet e investimeve kapitale, projektet që janë më shumë se një vit, të inkuadrohen në këtë dokumente bazë të Komunës, ndërsa sa i përket kategorive të tjera që janë “mallra dhe shërbime”, do t’i kemi dëgjimet buxhetore në korrik, kur ne e pranojmë edhe qarkoren e dytë, dhe e dimë saktësisht sa e kemi tavanin për secilën kategori

ekonomike sipas qarkores së parë, e pranuar nga Ministria e Financave, Komunës së Prishtinës 105 milionë euro do t'i takojnë për vitin 2023, të ndara në të gjitha kategoritë ekonomike.

**Alban Zogaj** theksoi se sot do të diskutojmë lidhur me një dokument shumë të rëndësishëm të Komunës së Prishtinës dhe qytetarëve të saj.

Korniza afatmesme buxhetore është një dokumente bazik i nivelit të lartë strategjik komunal dhe që jep një orientim të të hyrave të Komunës së Prishtinës, por edhe të shpenzimeve të tri viteve të ardhshme, 2023-2024-2025. Gjatë muajve të fundit kemi pasur një proces intern të diskutimeve dhe analizave se nga do ta orientojmë buxhetin dhe shpenzimet e Komunës së Prishtinës në tri vitet e ardhshme. Qëllimi i takimit të sotëm më shumë është me marrë nga ju ide, sugjerime, projektet që doni t'i shihni në kornizën afatmesme buxhetore, me shikuar a kemi lënë diçka anash apo i kemi përfshirë të gjitha.

Ky dokument i sotëm nuk është dokument final, keni kohë me diskutuar edhe në asamble, kemi kohë me diskutuar me ju, me i marrë sugjerimet nga ju edhe gradualisht me ndryshuar në ndërkohë. D.m.th. Korniza afatmesme buxhetore nuk është dokument i pandryshueshëm, është një dokumente dinamik që ndryshon, nuk është ky buxheti i vitit 2023, buxheti është një dokument tjetër, të cilin e përvetësojmë më vonë edhe për qytetarët e Prishtinës, edhe për asamble, edhe e votojmë, pastaj buxheti mbetet më statik dhe na jep njëfarë orientimi si t'i shpenzojmë mjetet tona në vitin 2023.

Ne jemi fokusuar te investimet kapitale, në mënyrë që të vijmë deri te një orientim se si do t'i shpenzojmë paratë - fondet e Komunës së Prishtinës në investimet kapitale për vitin 2023. E kemi një fond diku 40 milionë euro për investime kapitale, të cilat kryesisht janë të bazuara në premtimet e kabinetit tonë, premtimet e kryetarit Rama dhe në platformën mbi të cilën kryetari Rama i ka fituar edhe zgjedhjet e fundit lokale.

**Osman Bilaca** hapi diskutimin.

**Qerim Shabani**, qytetar, tha se do të fokuset vetëm në fshatrat e BL-së së cilës i përket, që kanë mbetur edhe pak projekte pa u realizuar, si kanalizimi, nga viti 2013, në Sharban - Halabak, po ashtu kanalizimi në Llukar nuk është vazhduar, ka mbetur pa u bërë kanalizimi Llukar - Makovc -Grashticë. Janë disa investime kapitale të vogla, diku 700 mijë euro, unë çdo herë i kom kërkuar për 7 fshatra nga 100 mijë euro për me i futur në punë. Tani t'i kemi parasysh që t'i fusim ato projektet që i kemi të gatshme për këto tri vite, e duam ujësjellësin dhe efqiencën e rrymës alternative me rrymë me erë.

**Krenar Xhaferi** dha sqarime, duke thënë se projekti ekziston në kuadër të investimeve kapitale, e kemi ndarë një pjesë të buxhetit për kanalizimin për fshatra dhe hyn në kuadër të këtij planifikimi.

**Ukshin Vllasa**, qytetar, ceku rrugën "Ismet Krasniqi" dhe pjesën te shkolla "Mehmet Gjevori". Ai tha se rruga te varrezat është shtruar në vitin 1986, hapësira e poshtme mbetet e pashfrytëzuar, andaj unë propozoj që kjo rrugë apo ky projekt të futet në projektet e parapara, sepse kjo rrugë e

lidh një pjesë të Podujevës, Vushtrrisë, Mitrovicës me Fushë-Kosovën, kështu që me ndërmarr diçka në atë pikë, se çdo rrugë që lidhet në te është e konfrontuar sepse bashkohen shumë rrugë. Problem tjetër janë korsi të. Po ashtu, rruga te varrezat, te varri i Bajram Kelmendit, edhe aty ka hapësirë me u bërë një rreth, me u rregulluar pjesa që lidhet me shkuar nga shkolla lart, që është rruga shumë e ngushtë dhe shumë e ngarkuar. Te shkolla me pasur prioritet me zgjedhur problemin e bartjes së nxënësve, ne jemi në rrezik për çdo ditë me pasur fatkeqësi duke i bartur fëmijët. Duhet t'u bëhet parking familjarëve që i sjellin fëmijët në shkollë. Janë bërë parkingje nëpër park, dita-ditës parku po zvogëlohet, shkolla ka bërë një kërkesë te Drejtoria e Arsimit, Këshilli i prindërve presin përgjigje nga ju. Unë po supozoj që do të bëhet një nënkallim aty.

Po ashtu, rruga që lidhet prej varrezave, prej varrit të Bajram Kelmendit që shkon për Orllloviq nuk ka ndriçim. Po ashtu, nga xhamia në pjesën e poshtme që shkon për Orllloviq, të njëjtën gjendje e ke me pusetat e hapura, të cilat vidhen nga njerëz të pandërgjegjshëm, ta bëni një zgjidhje, sepse edhe rruga është shkatërruar.

Unë kërkoj me bërë fizibilitetin e projektit, ju ndihmoj, vetëm me ma dhënë një teknik dhe dikush prej gjeodezisë me i bërë pikat dhe me bërë fizibilitetin e projektit. Kur të bëhet fizibiliteti me shikuar hapësirat ku mundet me bërë zgjidhje për me i dhënë përparësi. Po ashtu, kërkoj që herëve të tjera me pasur ndonjë material për takim.

**Krenar Xhaferi** dha sqarime, duke thënë se sa i përket pusetave ne si Komunë e kemi bërë ndarjen e qytetit në pesë zona, ky është planifikim i vitit 2023, dhe ndarja zonale ku mundet Dragodani, Emshiri dhe Orllloviqi me pasur një zonë dhe një kontraktor në kuadër të krejt zonës dhe kjo e zgjidh problemin.

**Ukshin Vllasa** tha se për puseta po ju kuptoj, por nuk e di kush e bënë pranimin teknik, se kur të bëhet pranimi teknik, të dihet si po bohet, se nuk është bërë pranimi teknik i asaj rruge prej që është bërë në vitin 1986 kurrë më nuk është bërë pranimi teknik se korseta prej korsete dallon.

**Donjeta Sahatçiu** falënderoi diskutuesin paraprak për praninë e tij dhe për angazhimin për kërkesat tuaja në të mirë të qytetarëve, sidomos të nxënësve të shkollës "Mehmet Gjevori".

Ju i përmendët tri informata, kam dëshirë me i elaboruar. E para, ju thatë që keni telefonuar një numër në shërbimet publike dhe nuk keni marrë përgjigje. Unë jam e interesuar me ditë se në cilin numër keni thirrur, që të sigurohem se ai numër është i qasshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që nëse nuk punon ose diçka të tillë duhet ta rregullojmë.

E dyta, ju përmendët mungesën e sinjalizimit që është afër shkollës, kontrata ka qenë e bllokuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe është një kontratë e re, tash brenda dy-tri jave pritet të nënshkruhet dhe do të ketë sinjalizim në gjithë qytetin, duke përfshirë edhe hapësirën ku jeni ju. E treta, mungesa e ndriçimit gjithashtu lidhet me kontratën për ndriçim, që lidhet me kontratën që është e bllokuar në OSHP, dhe kjo është një kontratë që kemi vendosur me hapur në disa lote që të mos bllokohemi, një operator ekonomik që ka ankesë shkon prapë në bllokadë, edhe kjo brenda dy -tri javëve nënshkruhet dhe të mbyllet si proces. Dhe e fundit, lidhur me sigurinë rreth shkollës dhe asaj sa është e qasshme hyrja e shkollës prej nxënësve. Unë kisha propozuar, e kemi edhe drejtorin e SHP-së, që të organizohet një vizitë e ekipit të tij afër shkollës. Ankesa të ngjashme kemi edhe prej shkollave të tjera, të bëhen vizita, të bëhen analiza, të bëhet matja dhe të bëjmë një ndërhyrje menjëherë pranë shkollës.

**Nexhmedin Llapashtica**, qytetar, pyeti se pse një qytetar i Prishtinës kur e sjell një ankesë me shkrim nuk i kthehet me shkrim, kujt i është dorëzuar ajo dhe nesër nëse ndodh ndonjë tragjedi për ata qytetarë që janë ankuar duhet të dënohet dikush. Unë i kam bërë 36 kërkesa, askush përgjigje nuk më ka kthyer. Sa i përket kësaj, dua të ceku se Kuvendi komunal i Prishtinës edhe para jush, por edhe i tashmi nuk jep dhurata për meritat e qytetarëve. Pse nuk i shpërbleni qytetarët kur japin një kritikë për rrezikimin e jetës së qytetarëve, një mirënjohje ose një lëvdatë për qytetarët që e kanë mbrojtur qytetarin.

Unë i kam nëntë pyetje. Pse çerdhja nuk është e lëshuar në lagjen "Pejtoni" dhe nuk punon. Në Prishtinë katër çerdhe i keni mbyll, pse fëmijët tanë shkojnë nëpër çerdhe private e ajo çerdhe është e mbyllur? E dyta, nëse ky buxhet është i ndarë, a ka mundësi të jeni solidar në këto momente, të gjithë qytetarët që i kanë fëmijët nëpër çerdhe, së paku 30% të kontribuoni në atë frakturë. Unë e kam një banesë e që jam i gatshëm me ia dhënë Kuvendit komunal të Prishtinës, që ka vlerë 40 mijë euro, që kryetari ta mbaj fjalën e vet, që unë me 300 njerëz e kemi votuar, për shkak se ka premtuar se do të fillojë "Rruga A". A ka filluar dhe a do të fillojë në mandatin e tij "Rruga A"?

E treta, nëse ka mundësi Kuvendi komunal të gjithë ata qytetarë të cilët kanë probleme jetësore të lirohen së paku 1-2 muaj ose 1 vit prej tatimit.

Po ashtu, ceku çështjen e rrugës „Agim Ramadani”, e cila është dëmtuar, dy autobusë nuk mund të lëvizin paralel me atë rrugën që e kanë bërë shtegun për biçikleta, ambulanca nuk po ka mundësi me hy në mes të dy kerreve, duhet të shqyrtohet kjo çështje e qytetit të Prishtinës.

Po ashtu, pyeti se çka po ndodhë me vrimat dhe shtyllat që i ka vendosur kryetari para jush, 36 mijë shtylla i ka vendosur Shpendi. Unë po dua me ia liruar vendin ndihmës së shpejtë që po vije mbrapa meje, por nuk mundem prej atyre. Sot e paraqita, unë 18 euro në muaj i harxhoj telefon duke e thirrë KK të Prishtinës, duke lajmëruar për defektin që ka qyteti i Prishtinës. Sot i paraqita 36 shtylla që janë në shesh dhe iu drejtova KK të Prishtinës, nëse nuk i largoni të dëmtuarat unë kom mi larguar. Unë prapë po ju them, jam i gatshëm ta shes banesën të investojë në Komunën e Prishtinës, që "Rruga A" të fillojë sa më parë se ajo është pasuri e qytetarëve. Po ashtu tha se duhet ta kemi një vend që qytetarët vërejtjet që i kanë në rrugë, vërejtjet që i kanë jetësore të kenë ku me i paraqitur, e pastaj më tutje këto ju mungojnë juve.

**Osman Bilaca** e falënderoi qytetarin dhe ceku se është i njohur për Komunën, si një qytetar më aktiv i Prishtinës. Secili prej qytetarëve që po e merre fjalën po e cek se e kam votuar kryetarin, kryetari nuk bën diferencime dhe është kryetar i secilit qytetar të Prishtinës, nuk bën diferencime as nga vota kah kanë ardhur, as nga lagjet, as nga familjet, kështu që për secilin vepron njëjtë dhe për secilin qytetar trajtimi është i njëjtë.

**Besianë Musmurati** sa i përket pyetjes për ndërtimin e çerdhes "Xixëllonjat", është projekt që me vite të tëra ka mbetur ashtu siç është dhe fëmijët që kanë qenë në këtë çerdhe janë transferuar në objektin "Pallati i Rinisë", ku nuk janë kushtet e përshtatshme për çerdhe. Për këtë jemi në dijeni dhe jemi duke punuar që menjëherë të fillojmë ndërtimin e çerdhes së re, por kontrata është ndërprerë për shkak se çmimet janë rritur shumë dhe në mungesë të vendimit të Qeverisë se si të veprojmë për raste të tilla, se çmimi është dy here më i lartë, atëherë ne jemi detyruar kontratën me e shkëputur dhe si Komunë të fillojmë zotimin me mjete të reja e pastaj ta përfundojmë ndërtimin.

**Krenar Xhaferi** sa i përket "Rrugës A", ne si drejtori e kemi përcjellë për ofertimë në Drejtorinë e Prokurimit, shumë shpejt publikohet, mjetet janë të ndara përafërsisht 3 milionë e gjysmë sivjet, 4 milionë vitin tjetër dhe në vitin 2024, 7 milion euro. 7 ditë mbasi kemi shkuar në zyrë e kemi nisur fillimin e projektit të "Rrugës A", sepse nuk ka pasur as projekte, e kemi përmyll fazën për 1.5 km dhe e kemi përcjellë atë për tenderim për vazhdim të projektit dhe me përfundimin e projektit fillojmë me pjesën tjetër.

**Albion Zeka**, qytetar, tha se kishim shpresë se kemi me parë dokumentin, por e kuptuam se është koha për propozime, besoj se është kohë e përshtatshme. Propozimi ynë sot ndërlihet me tri Prishtinat, është përputhje me tri Prishtinat e premtimeve edhe smart, edhe gjelbër dhe përjetimeve. Ka të bëjë me qasjen e personave me aftësi të kufizuara në mjediset publike. Pra kërkesa nuk është specifike, por një prej projekteve po kërkojmë në parashikimet buxhetore që keni me i bërë në kornizën afatmesme, me ndjekur një qasje dy drejtimeshe, e para secili projekt kapital që do të përzgjidhet prej Komunës, secili që do të jetë ai ta ketë një filtër të qasshmërisë për të gjitha grupet e aftësive të kufizuara, dhe e dyta, që është specifike, që i drejtohet kësaj kategorie, mbase do të ishte mirë këtë vit, sepse Prishtina shkon përtej mandatit të komunës së vet, mundë t'u jep edhe model komunave tjera. Të bëhet një plan për evitimin e pengesave me infrastrukturën ekzistues në qytet. Ne nuk po kërkojmë të zgjidhet brenda një viti, por të ketë një realizim progresiv të përmirësimit të qasjes.

**Donjeta Sahatçiu, nënkryetare**, tha se më duket ju mbetëm borxh lidhur me ankesat që thatë, i keni proceduar 36 prej tyre, kur e përmendët punën e protokollimit, të vulës, emrit, mbiemrit, ne e kemi Qendrën për shërbim me qytetarë, poshtë sportelet që presin palët, ju mundeni vetë me shkruar kërkesën, ajo protokollohet, i drejtoheni personit specifik me emër e mbiemër, me drejtori dhe kemi afat ligjor që duhet t'iu përgjigjen, andaj krejt procesi i kërkesës, ankesës është i definuar.

**Jahë Balaj**, banor, tha se unë kam ardhur në emrin tim personal, por edhe në emër të lagjes "Lakërishta", kam disa kërkesa që për mua janë bazike. E dimë se 22 vitet e fundit Prishtina shumë pak është zgjeruar, por shumë është ngushtuar, është rritur shumë numri i banorëve, kushtet infrastrukturore kanë mbetur të njëjta! Lagjja jonë është pesë - gjashtë herë me më shumë banorë, nuk kemi shkollë fillore, i kemi dy shkolla të mesme "Xhevdet Doda" dhe "Shtjefën Gjeçovi", por nuk kemi shkollë fillore, por kemi shumë fëmijë të shpërndarë nëpër shkollat "Faik Konica", "Dardania", "Xhemajl Mustafa", që duhet të kalojnë rrugë të rrezikshme. Unë e kam një propozim konkret, që shkolla "Shtjefën Gjeçovi" të shndërrohet në shkollë fillore dhe një pjesë e saj të bëhet çerdhe, sepse në lagjen tonë nuk ka as çerdhe, do të ishte një zgjidhje shumë e mirë.

Kjo lagje nuk ka as ambulancë, edhe për këtë jemi të shpërndarë në Dardani te Posta ose në Qendër. Ta keni parasysh, lagjes "Lakërishta" i thuhet BL e 2-të, ne nuk kemi BL, nuk e di a është në dijoni kryetari, kryesia e re, ku i bie me qenë BL e 2-të. Po ashtu e kemi një plato të ndërtesës së vjetër në "Lakërishtë", e cila është ndërtuar në vitet e 70-ta, kurrë nuk është investuar në atë plato. Në lagjen tonë një pjesë e rrugës, prej rrethit të madh deri te lagjja jonë, është e ndarë rruga me parmak, vërtetë është një pamje e keqe. Ai tha se kam dëgjuar se gypat që e sjellin ujë e pijshëm nëpër ndërtesa të Prishtinës janë të azbestit! Nuk di a duhet të ketë ndonjë projekt për ndërrimin e tyre, pasi e dimë që janë të dëmshëm për shëndetin. Sa i përket "Prishtina Parking", e kam dëgjuar nënkryetarin në një medie duke thënë se po funksionon mirë, por po i tregoj se ajo nuk funksionon mirë, ajo funksionon dhunshëm, ai është një krim ilegal.

**Valbona Ahmeti - Makolli** i dha sqarime Albionit, duke thënë se sa i përket pjerrinave ne e kemi projektin, që është Plani i mobilitetit, është drejtorja duke shikuar ku nuk janë, kryetari së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit janë në përgatitje të një Rregulloreje, që shumë shpejt do të dalë në dëgjim publik, asnjë leje nuk do t'i jepet investitorit nëse nuk parasheh pjerrina, kështu që nëse dini ku ka nevojë për pjerrina na dërgoni në email ose fizikisht, t'ia bashkëngjisim se është një Plan nëse është mirë, nëse jo ia bashkëngjisim.

**Osman Bilaca** tha se sa u përket kërkesave të zotëri Jahës, për kërkesën për shkollë fillore dhe çerdhe, hynë në kategorinë e arsimit, te Besiana Musmurati, sa i përket QMF-së hynë në drejtorinë e Shëndetësisë, ku nuk e kemi drejtorin prezent sot, është në vizitë jashtë Prishtinës, për BL drejtori nuk është këtu, por kam informatë se jemi në ndryshim të Rregullores për BL -të, te cilën e kemi qitë në Kuvend, e kemi marrë miratimin me qitë në diskutim publik, që është Rregullorja, do të miratohet e pastaj fillojmë me përzgjedhjen e kryetarëve BL -ve dhe funksionalizmin dhe ri funksionalizimin e të gjitha BL -ve.

**Besianë Musmurati** sa i përket ndërtimit të një shkollës fillore dhe potencialisht me shfrytëzuar objektin e shkollës "Shtjefën Gjeçovi", që e përmendet ju shkollën "Shtjefën Gjeçovi", ka kaluar në kompetenca të Ministrisë si shkollë dhe nuk e bënë Komuna menaxhimin, mirëpo sa i përket planit, ne jemi duke shikuar bashkë me Drejtorinë e Planifikimit Strategjikë, Drejtorinë e Urbanizmit të bëjmë, të identifikojmë sa më shumë toka komunale që t'i shfrytëzojmë për ndërtimin e shkollave të reja dhe çerdheve të reja. Ju e dini se ndërtimi i çerdhes do të bëhet te shkolla "Xhemajl Mustafa" dhe jemi në shqyrtim që të bëjmë një plan afatgjatë dhe ta planifikojmë në buxhet që të ndërtojmë shkolla dhe çerdhe të reja ku ka nevojë dhe më shumë prioritet, kështu që jemi në proces të planifikimit jo vetëm të lagjes suaj, por shumë lagje të Prishtinës se kemi mbi ngarkesa në shkolla dhe çerdhe.

**Gent Konjuhi**, qytetar, desha me u njoftuar për pjesën ku unë jetoj, e cila është në "Kurriz", dhe desha me adresuar problemin me projektin "Kurrizi", që asnjëherë nuk ka mbërri me u përfunduar deri në fund, ka pjesë që nuk janë kryer, që sipas projektit ka qene edhe ndriçimi, pjesët ku janë pllakat nuk janë shtruar në disa vende, po ashtu edhe i është ndryshuar struktura e "Kurrizit". Desha të dijë prej jush se a do të vazhdojnë punimet në këtë projekt, sa u përket këtyre investimeve që po i quani ju kapitale, edhe nëse nuk vazhdojnë a do të ketë ndonjë projekt të ri dhe a do të merren masa ndëshkuese ndaj kompanisë që nuk i ka kryer punët etj.?

**Krenar Xhaferi** tha se fillimisht aty duhet bërë një analizë të hidroizolimit. Ne sivjet do ta analizojmë pjesën e hidroizolimit fillimisht. Për me vazhduar pjesën e projektit normalisht që duhet me ndërhyrë, është shumë keq, unë e kam vizituar disa herë, d.m.th. është gjendja shumë e keqe dhe duhet me ndërhyrë.

**Nexhmedin Llapashtica** tha se çdo herë i falënderohem Kuvendit komunal për ndonjë reagim të shpejtë, ajo që po më brengos është që 9 muaj te teatri kanalizimi dhe puseta e hapur në qendër të Prishtinës, kjo është për keqardhje, pse po ndodh kjo?! Unë jam ai person i cili të dy kanalizimet mbrapa Teatrit i kom lidhur me lumin, të dy kanalizimet dikush i kishte mbyllur mbrapa Teatrit. Po ashtu, ceku se është Ligji i cili është i miratuar më 23.09.2007, asnjë kamion mbi 6 ton nuk mundet me ecur nëpër qytetin e Prishtinës prej orës 8 - 16, i kam numëruar te Rrethrrrotullimi i Flamurit për një orë i kam regjistruar me numra me krejt 113 kamionë për një orë, shikoni është Ligji, ju lutem merrni masa se fëmijët tanë po pësojnë, andaj veproni e shpëtoni fëmijët tanë.

**Krenar Xhaferi** dha sqarime se pjesën e gropave në qytet që e përmende, ne qe sa vite realisht Komuna e Prishtinës ka pasur një kontraktor të skanimit të gropave, pikërisht ka qenë ky qëllimi që me decentralizuar dhe me u nda Komuna e Prishtinës në 5 zona dhe mirëmbajtje 24 orë në kuadër të zonës. Ky është qëllimi i intervenimeve të shpejta të cilat na vetëm i kemi planifikuar për vitin 2023, që me startuar me këtë projekt do të jetë një kontraktor në kuadër të zonës dhe me arritur sa më shpejt te intervenimi i cili është urgjent për secilin prej nesh.

Sa i përket kanalizimit te Teatri, Ministria e Kulturës e ka marrë për sipër dhe e ka tenderuar rregullimin e kanalizimit tek te Teatri, është projekt i Ministrisë së Kulturës, kështu që kanalizimi te Teatri ka qenë i kontraktuar prej Ministrisë së Kulturës.

**Nexhmedin Lllapashtica** ceku se 8 mijë denarë ose 53 euro, i ka fituar në Shtetin e Maqedonisë ku ka parë kafshë të ngordhura dhe ka lajmëruar, i kanë thënë ku gjendesh qëndroj aty ku je, kanë ardhur paret mi ka pru veç që e kam lajmëruar shtetin që një kafshë e ngordhur është, ti sjell paratë aty brenda 15 minutave, te ne pse nuk vinë menjëherë dikush, kush je, ku je vetëm me shikuar me konstatuar, me të vërtetë të mirat duhet mi marrë.

Po ashtu ceku se për 1 Qershor në Shtetet për rreth, 120 euro ua kanë dhënë të gjithë fëmijëve që janë fatosa, deri 6 vjeç për 1 Qershorin. A thua vallë 30 euro shtesa fëmijët tanë ose Kuvendi komunal nuk i shpërblej këta fëmijë, pse nuk ju dha nga 20 euro.

**Krenar Xhaferi** në kuadër të projektit për 5 zona, ideja është 24 orë me monitorua zonën me dy vetura, d.m.th. ideja është me u zgjeruar edhe më shumë që me pasur vrojtues të lagjes, që me përcjell gjithë këtë shqetësimin tënd, kjo është ideja e 2023, është hera e parë që do të implementohet në komunën e Prishtinës.

**Gent Shkodra**, qytetar, tha se i ka dy pika të interesit. Tash e sa vite flitet për një kycje që ka me u bërë njëkahore apo dykahore, te rrethi në Veternik, te pompa "Shell". Po ashtu, flitet edhe për një shkollë, besa edhe për një QMF mbrapa lagjes "Qëndresa", a ka mundësi dikush me më dhënë informata?

**Besianë Musmurati** tha se edhe ky është një problem tjetër, të cilin e kemi në realizimin e investimeve kapitale, shkolla është e bllokuar, edhe 2 shkolla tjera janë të bllokuara në OSHP deri në funksionalizimin e OSHP-së, Bordi i tyre. Ne nuk mund të vazhdojmë me projekte, jemi duke pritur Qeveria të bëjë zhbllokimin e OSHP-së dhe të zhbllokohen të gjitha projektet kapitale të Komunës së Prishtinës dhe të bëhet ndërtimi i shkollave.

**Osman Bllaca** tha se sa i përket përgjigjes për QMF si për lagjen "Qëndresa", edhe për lagjen "Lakërishta" ia përcjellim drejtorit Izet e ai ju përgjigjet në pyetjet e juaja.

**Krenar Xhaferi** tha se për kyçjen e rrugës ka nevojë sqarim. Për këtë rrugë çdo herë flitet e asnjëherë gjë konkrete nuk ka.

**Jahë Balaj**, qytetar, tha se këtu sa herë dëgjova fjalën Qeveri, d.m.th. problemi me Qeveri edhe ne po i shohim ato probleme me Qeverinë, por ju lutem zgjidhni këto probleme se nëse projektet hupin, humbim ne e jo ju.

**Osman Bllaca** tha për punët e Qeverisë ne nuk mundemi me folur, por ato janë të ndërlidhura, çdo punë e një drejtorie ndërlidhet me ministrinë e linjës dhe kjo është arsyeja pse ne çdo herë na bie me përmendur.

**Nexhmedin Lllapashtica** ceku edhe lagjen "Kalabria", e cila i ka 136 mijë banorë dhe "Dardania", e ka lutur ish-ministrin e Infrastrukturës, z. Xhemaili, që nga ngrohtorja deri te

rrethrotullimi lart të bëhet një urë dhe jepja mundësinë që këto dy lagje të bashkohen, po duhet prej "Kalabrisë" me shkuar te posta ose te sheshi "Bill Klintoni" për të hyrë në Dardani, a ka buxhet dhe a e keni menduar që patjetër kësaj rruge t'i bëhet një zgjidhje, "Kalabria" te Stacioni i Autobusëve, dhe a ka mundësi që të kërkohet nga Stacioni i Autobusëve që qytetarët me shfrytëzuar pa pagesë nënkalin.

**Krenar Xhaferi** u përgjigj, duke thënë se i kemi pasur mbi 10 takime me Stacionin e Autobusëve dhe e kemi bërë pjesën e projektit, që shumë shpejt do të implemetohet, që nënkalimi me qenë i shfrytëzueshëm për qytetarë, e pjesa tjetër do të krijohet edhe një korsi tjetër, kështu që tri korsi do të mbesin te Stacioni i Autobusëve për autobusë dhe 2 korsi për qytetarë.

*Debati përfundoi në orën 11:30.*



Pjesëmarrja në diskutim publik, Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025 (KAB), në Kryeqytet, më 15.06.2022.

Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nënskrimi
1 Ushëria Vloza			
2 ZAKUP ADAMI			
3 Adnan Paçi			
4 FERIDI SYLLEIMANI			
5 ARUELLA HOXHA			
6 ALBION ZEKA			
7 SADRI REXHEVA			
8 SAMI BOROZI			
9 GJERT SHKODRA			
10 Gent Korychi			
11 Lectin Rikard			
12 Donika Ahmetaj			
13 Denisa Arçani			
14 TRERA KASIMI BEPISHA			
15 NEXHMEJDI LAROSHANI			
16 JETA RAFUNA HASANI			
17 JAHË BAZAS			
18			